



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:071732

Datë: 08.02.2019

Numri i dokumentit: 00221340

P.nr.79/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Ronita Halimi, në çështjen penale kundër të pandehurit R. H. nga fshati Zhegër, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, të cilin me autorizim e mbron avokati Ymer Huruglica nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.2073/2018, të datës 21.01.2019, pas mbajtjes së seancës dëgjimore mbi pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datë 01.02.2019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri R. H., nga babai dhe nëna, e lindur i lindur me datë 14.07.1986, në Gjilan, me vendbanim në fshatin Zhegër, Komuna e Gjilanit, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i katër fëmijëve, i punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 26.12.2018, rreth orës 19:00 h, në shtëpinë e shëndetit në fshatin Zhegër, Komuna e Gjilanit, i pandehuri me dashje, me përdorimin e atëçastshëm të dhunës dhe me kanosje serioze për sulm, e ka sulmuar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare edhe atë mjekun kujdestar të dëmtuarin F. Q., ashtu që për shkak të mosdhënies së ndihmës mjekësore nga ana e mjekut ndaj vajzës së tij 2 vjeçare, për shkak të grevës së përgjithshme të stafit shëndetësor, i njejtë në shenjë revolte shkon në shtëpi e merr sëpatën dhe kthehet në shtëpinë e shëndetit dhe me sëpatën si mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore, e sulmon të dëmtuarin duke tentuar që ta godas me sëpatë, mirëpo i dëmtuari arrin që ta kapë me dorë sëpatën dhe që të dy kacafyten mes vete deri sa vijnë zyrtarët policor të cilët ndërhyjnë dhe e arrestojnë të pandehurin, i cili veprimet e tij i ka drejtuar kundër të mirës juridike që konsiston në rrezikimin e integritetit trupor dhe autoritetin e zyrtarit në kryerjen e detyrave zyrtare.

-Me çka ka kryer veprën penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 4,41,42,43,45,46,47,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe nenit 247 dhe 365 të KPP-ës, të pandehurit i shqipton:

**DËNIM ME BURGIM I CILI DËNIM ME PËLQIMIN E TË PANDEHURIT
ZËVËNDËSOHET NË DËNIM ME GJOBË**

Ashtu që të pandehurit R. H. i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim në bazë të nenit 47 të KPRK-ës dhe me pëlqimin e të pandehurit do të zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 1800 € (njëmijë e tetëqind euro), të cilin dënim do t'a paguajë në afat prej 3 (tre) muajve, pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mund ose nuk është në gjendje që ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti kthehet në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve.

Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 25 € (njëzetepesë euro), në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Me datë 21.01.2019, Prokuroria Themelore në Gjilan, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën me numër PP.nr.II.nr.2073/19, të datës 21.01.2019, kundër të pandehurit R. H. nga fshati Zhegër, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Me datë 24.01.2019, pranë kësaj gjykate është caktuar seanca e shqyrtimit fillestar në të cilin ishin prezent i pandehuri R. H. dhe i dëmtuari F. Q. ndërsa mungoi mbrojtësi i të pandehurit me autorizim avokati Ymer Huruglica, i cili përmes parashtrësës ka kërkuar që kjo seancë të shtyhet ngase i njejtë do të prezantoj me një seancë tjetër në Departamentin për Krime të Rënda, seancë kjo e cila ka qenë e caktuar më parë, për çka si dëshmi ka bashkangjitur edhe një kopje të procesverbalit të shqyrtimit paraprak me numër PKR.nr.99/18, të datës 12.12.2018, po ashtu i njejtë ka shtuar se gjatë kësaj kohe tiu ipet mundësia që të negociojnë edhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ngase për një gjë të tillë i pandehuri ka shprehur vullnetin e tij. Më datë 29.01.2019 pranë kësaj gjykate është dorëzuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë me numër PP.II.2073/2018, ndërsa me datë 01.02.2019 pranë kësaj gjykate është caktuar dhe mbajtur seanca dëgjimore për pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me numër PP.II.nr.2073/2018, të datës 28.01.2019, të arritur ndërmjet Prokurorisë Themelore në Gjilan në njërën anë dhe të pandehurit R. H. në anën tjetër, në këtë seancë prezantuan prokurori i shtetit, i pandehuri R. H. me mbrojtësin e tij me autorizim av.Ymer Huruglica si dhe i dëmtuari F. Q., në të cilën seancën gjyqtari i vetëm gjykues me aktvendim ka aprovuar marrëveshjen e lartcekur sipas të cilës gjykatës i është rekomanduar që të pandehurit për veprën penale e cila i vihet në barrë ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit të zëvendësohet në dënim

me gjobë me çrast gjyqtari i vetëm gjykues të pandehurit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar në dënim me gjobë dhe të njëjtit i është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1800 € (njëmijëtetëqind euro).

2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Me datë 01.02.2019, pranë kësaj gjykate është caktuar dhe mbajtur seanca dëgjimore për pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me numër PP.II.nr.2073/2018, të datës 28.01.2019, të arritur ndërmjet Prokurorisë Themelore në Gjiilan në njërën anë dhe të pandehurit R. H. në anën tjetër, në të cilën seancë prezantu, i pandehuri i lartcekur me mbrojtësin e tij me autorizim Av. Ymer Huruglica nga Gjilani si dhe i dëmtuari F. Q., me çrast pas dëgjimit të palëve gjyqtari i vetëm gjykues pasi ishte bindur se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 233 pika 18 të KPP-ës, në bazë të nenit 233 pika 21 të KPP-ës, mori aktvendim me të cilin ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të arritur në mes Prokurorisë Themelore në Gjiilan në njërën anë dhe të pandehurit R. H. në anën tjetër.

Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se marrëveshja e lartcekur i përmbushë të gjitha kushtet ligjore si dhe e njëjta është arritur në bazë të nenit 233 të KPP-ës, po ashtu gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar faktin se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 253 paragrafi 1 e 2 të KPP-ës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri R. H. ka kryer veprën penale kanosja nga neni sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, në vendin, kohën dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1, nënparagrafi 3 të KPRK-ës, ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë që të pandehurit t'i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit të zëvendësohet në dënim me gjobë nga ana e gjykatës, me çrast gjyqtari i vetëm gjykues me pëlqimin e të pandehurit dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajve ia zëvendësoi në dënim me gjobë në shumë prej 1800 € (njëmijëtetëqind euro), ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Gjithashtu gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74 dhe 75 të KPRK-së ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjiilan në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar për veprë tjetër penale, se i njëjti është penduar për veprimet e veta dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej

vepra tjera penale, se i njejtë është mbajtes i familjes, po ashtu sjelljen e të pandehurit pas konflikti ku nga shkresat e lëndës por edhe nga deklarimet e palëve shihet i pandehuri dhe i dëmtuari asnjëherë më nuk kanë pasur probleme mes vete, gjithashtu gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh edhe faktin se deri tek konflikti mes të pandehurit dhe të dëmtuarit ka ardhur për shkak të mosdhënies së ndihmës mjekësore nga ana e të dëmtuarit, i cili ishte në pozitën e mjekut mirëpo të cilët ishin në grevë dhe për këtë arsye edhe nuk i ka ofruar ndihmën e nevojshme mjekësore mirëpo gjendja shëndetësore e vajzës së të pandehurit e cila sipas shkresave të lëndës ishte me temperatur prej 41 gradë ishte edhe arsyeja se pse ka ardhur deri tek konflikti mes tyre ngase të njejtit më parë nuk kanë pasur probleme ndërsa si rrethanë rënduese gjyqtari ka marrë faktin i pandehuri pasi që nuk kishte marrë ndihmën mjekësore të nevojshme për vajzën e tij, të njejtën e dërgon në një ordinancë private me çrast edhe e merr ndihmën mjekësore e pastaj shkon në shtëpi dhe me paramendim e merr sepatën dhe shkon në ambulancën e fshatit dhe e sulmon të dëmtuarin në vendin e tij të punës.

5. Shqiptimi i dënimit në harmoni me pëshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me pëshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegësis së të pandehurit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarin gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurit ta obligojë ti paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 25 € (njëzetepesë euro), në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

7. Vendimi lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjyqtari i vetëm gjykues, në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, te dëmtuarin Ridvan Haziri e udhëzoi ne kontest te rregullt juridiko-civil.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dspozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.79/2019, me datë 1 Shkurt 2019

Procesmbajtësja,

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Ronita Halimi

Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij akgykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.